



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.10.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR VENDOSJEN E BIZNESEVE NË
ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË QYLAGË –FAZA E PARË

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtari i Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qytagë –faza e parë, Ferdian Shala në numrin rendor 5, nga shoqëria civile, i emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.330/01-28079 të datës 31.05.2022 për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qytagë –faza e parë sipas kërkesës së tij për dorëheqje dhe në vend të tij caktohet **Bekim Krasniqi** poashtu nga shoqëria civile i përzgjedhur përmes ftesës publike për aplikim.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë , mandati dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qytagë –faza e parë 15Nr.330/01-28079 të datës 31.05.2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15 Nr.020/01-59169

Lipjan, më 31.10.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

